



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytëtarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Monitoruesi i Korrupsionit

Shifrat e Korrupsionit në Kosovë - Platforma e Statistikave Anti-
Korrupsion
Janar-Qershor 2013



Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga
Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur KFOS.

Përmbajtja

Hyrje	3
Prokuroria e Kosovës	4
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	5
Policia e Kosovës	5
Agjencia Kundër Korrupsion	6
Qeveria e Kosovës	6
Kuvendi i Kosovës	7
Falënderime	9
Rreth FOL-it	9

Monitoruesi i Korrupsionit

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

DHKEK - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

PK - Policia e Kosovës

PSRK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

SKK PV - Strategjia Kundër Korrupsion dhe Plani i Veprimit

Hyrje

Krijimi i politikave kundër korrupsionit, përgjatë këtij gjysmë-viti, është përshkruar me një tendencë qartësisht kundërthënëse për sa i përket miratimit të politikave anti-korrupsion. Në thelb, zhvillimet përgjatë këtij gjashtë mujori të parë të vitit 2013 në fushën anti-korrupsion, vënë në pah shumë qartë mungesën serioze dhe të sigurtë të zyrtarëve të lartë publik në krijimin e një kornize efektive anti-korrupsion.

Që nga fillimi i vitit 2013, Kodi Penal i Kosovës është pasuruar me amendamente të reja, thelbësore sipas shoqërisë civile, që ndëshkojnë penalisht disa nga veprat e korrupsionit. Çështjet e ‘deklarimit të rrejshëm të pasurisë’; ‘refuzimit për ta deklaruar pasurinë’, por edhe ‘penalizmi i konfliktit të interesit’, i janë shtuar Kodit Penal të Kosovës si disa prej veprave kundër korrupsionit. Penalizmi i këtyre veprave, krahas atyre që kanë qenë të përfshira në Kodin Penal, përbën një të arritur të Kosovës kundrejt mbylljes së hapësirave dhe boshllëqeve në bazën ligjore anti-korrupsion.

Sidoqoftë, krahas këtij përparimi në legjislacionin kosovar, rezultatet e të cilit ende nuk mund të maten cilësisht, ka pas edhe një tendencë, në thelb të kundërt, në fushën anti-korrupsion. Një numër deputetësh, zyrtarësh të lartë publik, por edhe drejtues të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë argumentuar në favor të mos publikimit të formularëve të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik në ueb-faqen e Agjencisë Kundër Korrupsion. Megjithëse, argumenti kryesor i përkrahësve të mos publikimit të formularëve të pasurisë bazohet në argumentin e cenimit të privatësisë individuale, përkundër të asnjë rasti të raportuar mbi këtë bazë, pushteti në Kosovë nuk është i interesuar për krijimin e mekanizmave efektiv kundër korrupsionit.

Ky raport është përmbledhje e Statistikave Kundër Korrupsion të Institucioneve relevante në këtë fushë, është rezultat i punës gati tri vjeçare në fushën anti-korrupsion të Lëvizjes FOL. Kjo platformë i mundëson opinionit të gjerë publik dhe institucioneve publike që t’i lexojnë vetë këto të dhëna të përmbledhura anti-korrupsion në një vend, dhe që këtë të mund ta bëjnë duke u bazuar në të dhëna të matshme. Më tej, kjo platformë do të ndihmoj për të kuptuar dhe analizuar më mirë punën dhe kontributin e institucioneve anti-korrupsion, por edhe parë dobësitë me të cilat institucionet përballen.

Lëvizja FOL tashmë ka krijuar një bazë të dhënash që është tërësisht e re, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Këto të dhëna do të freskohen në vazhdimësi, dhe kategori të reja do të krijohen për të zhvilluar më tej këtë qasje e cila është jetike në veçanti për matjen e ndikimit të zbatimit të ligjeve dhe politikave anti-korrupsion në vend.

Prokuroria e Kosovës¹

Gjatë periudhës raportuese Janar-Qershor 2013, Departamentet e Krimeve të Rënda të Prokurorive Themelore si dhe Speciale të Kosovës kanë pranuar në punë gjithsejtë 279 kallëzime penale kundrejt 637 personave. Nga viti paraprak Prokuroria e Kosovës ka trashëguar 281 kallëzime penale, ndërkaq në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pazgjidhura 1140 kallëzime penale kundrejt 404 persona.

Po gjatë kësaj periudhe gjatë të cilës po raportojmë janë zgjidhur 359 raste prej të cilave; kundër 43 personave janë hedhur kallëzime penale, kundër 18 personave është paraqitur aktakuzë e drejtpërdrejtë, janë pushuar hetimet kundër 112 personave dhe kundër 47 personave prokuroritë kanë paraqitur aktakuza pas procedurës hetimore. Ndërkaq, nuk kanë përfunduar hetimet ende ndaj 177 personave.

Korrupsioni në numra

281 të trashëguara nga viti i kaluar

Kallëzime Penale

279 të pranuar në punë

Kallëzime Penale

1140 të pazgjidhura

Kallëzime Penale

Prokuroria e Kosovës




Graf. 1.0. Të dhënat e Departamentit të Krimeve të rënda të Prokurorive Themelore si dhe Speciale të Kosovës.

¹ Në kuadër të Prokurorisë i analizojmë të gjitha veprat që sanksionohen me kapitullin XXIX të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës²

Gjykatat Themelore të Kosovës gjatë periudhës sa ne po raportojmë si lëndë në punë e të cilat janë në proces të shqyrtimit i kanë gjithsejtë 239 lëndë. Për dallim nga 6 mujori i vitit 2012, ku Gjykatat Komunale i kanë zgjidhur gjithsej 64 lëndë, këtë vit numri i lëndëve të zgjidhura është shumë më i vogël, gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti janë zgjidhur vetëm 14 lëndë, nga të cilat; 2 lëndë kanë përfunduar më dënim me burg; 5 lëndë dënim me gjobë; 5 lëndë dënime me kusht dhe; 2 lëndë kanë marrë dënime të tjera.


Ndërkaq, në fund të periudhës raportuese Gjykatat Themelore i kanë gjithsejtë 225 lëndë të pazgjidhura.



Graf. 1.1. Të dhënat e Gjykatave Themelore të Kosovës.

Policia e Kosovës³

Sipas statistikave të Policisë së Kosovës respektivisht Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK), rezulton se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2013 kanë hetuar në total 389 raste dhe kanë arrestuar gjithsejtë 49 zyrtarë të ndryshëm publikë. Përveç kësaj, DHKEK ka dërguar 226 raste në Prokurori me kryerës të njohur; 5 raste me kryerës të panjohur (N/N); dhe 18 raste me Raport të Veçantë të Prokurorit dhe kundër 389 të dyshuarve është ushtruar Kallëzim Penal.



Graf. 1.2. Të dhënat e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion.

² Në kuadër të monitorimit tonë të Gjykatave të rregullta të Republikës së Kosovës, analizojmë vetëm tri kategoritë kryesore që kanë të bëjnë me veprat penale me natyrë korruptive; Shpërdorimi i pozitës zyrtare, marrja e rryshfetit, dhënia e rryshfetit.

³ Në kuadër të statistikave të DHKEK, ne analizojmë veprat penale nga Kapitulli 25, 27 dhe 34 të Kodit të ri Penal të Kosovës.

Agjencia Kundër Korrupsion

Përgjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013 ka qenë e fokusuar në Publikimin e Raportit 1 vjeçar të punës së saj për vitin 2012. Në këtë raport, AKK-ja ka ofruar statistika përmes së cilave synon të dëshmoj përpjekjet e saja në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Ky raport i Agjencionit tregon se gjatë vitit 2012, AKK ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në gjithsejtë 244 raste, prej të cilave 80 prej tyre janë bartur nga vitet paraprake, kurse gjatë vitit 2012 janë pranuar edhe 164 raste të reja. Prej tyre 52 raste, janë përcjell në Prokurori dhe Polici për procedim të mëtutjeshëm, 7 raste janë përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 114 raste janë mbyllur, ndërsa 71 raste janë në procedurë⁴.

AKK-ja gjatë kësaj periudhe raportuese ka përmbyllur edhe procesin e Deklarimit të Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik. Këtë vit numri i zyrtarëve të lartë publik që kanë qenë të obliguar që ta deklarojnë pasurinë ka qenë 3869. Nga ky numër, obligimin ligjor e kanë përmbyllur 3834, ndërsa numri i atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë është 30, e nëse e krahasojmë me vitin paraprak ka qenë 261 persona të lartë publikë që nuk e kanë deklaruar pasurinë e tyre.

Agjencioni Kundër Korrupsion po gjatë kësaj periudhe ka nxjerr edhe një raport analitik ku në një farë forme ka bërë harmonizimin e statistikave kundër korrupsion të institucioneve gjegjëse që merren me këtë dukuri. Agjencia i ka mbledhur të dhënat statistikore të rasteve të dyshuara korruptive nga këto institucione tjera relevante si; Policia e Kosovës (PK), Doganat e Kosovës (DK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Prokuroritë dhe Gjykatat⁵.


Qeveria e Kosovës

Qeveria e Kosovës, respektivisht prijësi i saj kryeministri Hashim Thaçi qysh nga fillimi i mandatit e ka përsëritur frazën “Zero tolerancë ndaj korrupsionit”, mirëpo se sa po praktikohet kjo tregojnë statistikat e përmbledhura kundër korrupsion, e sidomos nëse i analizojmë vendimet që i ka nxjerr qeveria në këtë fushë. Nëse bëjmë një krahasim me 6 mujorin e parë të vitit 2012, ku Qeveria ka nxjerr 4 vendime në fushën kundër korrupsion, këtë 6 mujor të vitit 2013 Qeveria nga 183 vendime sa ka miratuar vetëm 1 është në fushën “kundër korrupsion”. Nëse i shikojmë vendimet sipas muajve, gjatë muajit janar Qeveria ka nxjerr 24 vendim; në muajin shkurt 32 vendime; gjatë muajit mars 33; në muajin prill 39; në muajin maj 26 dhe përgjatë muajit qershor ka nxjerr 29 vendime.

⁴ Agjencia kundër Korrupsion, Raporti Vjetor 2012, faqe 3. <http://www.akk-ks.org/repository/docs/Faktet%20kryesore%20te%20raportit%20vjetor%202012.pdf>

⁵ Më gjerësisht shih; [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raport_Analize_2012%20\(1\).pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raport_Analize_2012%20(1).pdf)

Vendimi i parë dhe i vetmi në fushën kundër korrupsion për këtë 6 mujor është nxjerr gjatë muajit shkurt, respektivisht me 13 shkurt 2013.⁶ Me këtë vendim Qeveria ka miratuar kërkesën e Prokurorisë Speciale për kompensimin e shtesave dhe stimulimin financiar të punonjësve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për vitin 2013. Shtesat në total për këtë organ do të jenë 148,176.00 €. Në PSRK punojnë 10 prokurorë vendor si dhe prokurorë nga misioni EULEX. Ndërkaq, numri i personelit mbështetës është 36.⁷



Graf. 1.3. Vendimet e Qeverisë së Kosovës.

Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues dhe demokratik në vend, për dallim nga gjashtë mujori i parë i vitit të kaluar këtë vit është treguar më produktiv në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Nga 26 seanca plenare sa ka mbajtur gjithsejtë, në katër prej tyre ka diskutuar për luftën “kundër” korrupsion: a) Shqyrtimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017; b) Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfitur me vepër penale; c) Shqyrtimi i propozim-Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017 dhe d) Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2012.

Me datë 21 janar 2013, Kuvendi i Kosovës ka debatuar për Strategjinë Kundër Korrupsion dhe Planin e Veprimit 2013-2017. Pas disa kritikave si dhe rekomandimeve e njëjta strategji është votuar në seancën e 11 shkurtit 2013, e cila me 54 vota për, 45 kundër dhe 2 abstenime është miratuar nga ana e Kuvendit. Rezultat e kësaj strategjie mbetet të maten gjatë muajve dhe viteve në vijim.

Po gjatë seancës së 11 shkurtit, Kuvendi miratoi edhe Ligjin për kompetencat zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfitur me vepër penale. Ky ligj u miratua pas shumë debateve dhe kritikave drejtuar këtij ligji si nga ana e Shoqërisë Civile po ashtu edhe nga vet deputetët e Kuvendit të Kosovës.


⁶ Qeveria e Kosovës, vendimi nr. 13/115 (13.02.2013)

⁷ Prokuroria Speciale e Kosovës, <http://www.psh-ks.net/?page=1,16>

Monitoruesi i Korrupsionit

Më 06 qershor të vitit 2013, Kuvendi ka diskutuar për Raportin e Punës të Agjencisë Kundër Korrupsion për vitin 2012. Ky raport është prezantuar nga Arben Gashi në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi. Pas disa diskutimeve, Raporti është hedhur në votim, e i cili me 33 vota pro, 25 kundër dhe 3 abstenime është miratuar nga parlamentarët e vendit.

Pavarësisht se Kuvendi ka diskutuar në këto 4 seanca për korrupsionin, shikuar nga aspekti cilësor nuk është se kanë pasur deri tani ndonjë im pakt në luftimin serioz të korrupsionit.



Korrupsioni në numra

- a) Shqyrtimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017;
- b) Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale;
- c) Shqyrtimi i propozim-Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017
- d) Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2012.

Graf. 1.4. Numri i seancave plenare të Kuvendit të Kosovës dhe i çështjeve të ngritura në fushën Anti-korrupsion.

Falënderime

Ky Raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i Lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Po ashtu falënderon edhe Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur KFOS. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë web faqe: www.levizjafol.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.